



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIVJAKË  
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

10988  
Nr. \_\_\_ Prot

Divjakë, më: 17/10/2025

**LËNDA: PROJEKT PËR KONSULTIM PUBLIK**

**“MBI DISKUTIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËR VITET 2026-2028”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, që përcakton parimet e përgjithshme dhe organizimin e funksioneve të njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri;

Në përputhje me Ligjin nr.9936 datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili rregullon menaxhimin e burimeve financiare publike dhe procesin e hartimit të buxhetit në nivel lokal dhe qendror;

Në vijim të Ligjit nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i cili garanton autonominë financiare të njësive vendore, si dhe përcaktion mekanizmat e ndarjes së burimeve financiare nga niveli qendror drejt atij vendor;

Referuar Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i cili rregullon metodologjinë dhe hapat e detajuar për hartimin e planifikimit buxhetor afatmesëm;

Në përputhje me Kuadrin Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2026-2028, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.83, datë 05.02.2025, i cili përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028;

Si edhe duke marrë parasysh Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”, Udhëzimit Plotësues nr.19, datë 10.07.2025, të Ministrit të Financave dhe të Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”.

Ligjit nr. 9970 dt.24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465 dt.18.07.2012 “Për integrimin gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”.

Udhëzimit Plotësues të Kryetarit të Bashkisë Divjakë nr.261 datë 28.07.2025 “Për përgatitjen e PBA 2026-2028 dhe Buxhetin e Vitit 2026 në Bashkinë Divjakë”, kemi përgatitur dokumentin paraprak të Programin Buxhetor Afatmesëm për Vitet 2026-2028 për konsultime publike.

Konsultimi publik për programin buxhetor afatmesëm është një proces i rëndësishëm, që synon përfshirjen e qytetarëve, grupeve të interesit dhe institucioneve në diskutimin e planeve financiare dhe prioriteteve të bashkisë për disa vite. Ky konsultim është një mënyrë për të garantuar



transparencë në procesin e hartimit të buxhetit, duke u siguruar që zëri i komunitetit të merret në konsideratë në vendimmarrje.

Në rastin e programit buxhetor afatmesëm, i cili përfshin një periudhë prej tre deri pesë vite, Bashkia Divjakë paraqet jo vetëm planifikimin e ardhurave dhe shpenzimeve për vitin aktual, por edhe për projekte të cilat do të zhvillohen dhe financohen në vitet në vijim. Konsultimi publik përfshin takime me qytetarët, shpërndarje të materialeve informative dhe marrje të sugjerimeve nga publiku për përmirësimin e programit buxhetor.

Gjatë këtyre konsultimeve, diskutohen çështje kyçe si:

- Prioritetet e zhvillimit të komunitetit, duke përfshirë investimet në infrastrukturë, edukim, shëndetësi, dhe shërbime publike.
- Mundësitë për të rritur të ardhurat e bashkisë përmes burimeve vendore dhe fondeve të jashtme.
- Politikat e shpenzimeve për të siguruar që fondet janë përdorur në mënyrë të drejtë dhe efikase.
- Zhvillimi i projekteve me ndikim afatgjatë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore dhe në bazë të Udhëzimit nr.8 dt. 28.02.2025, ka planifikuar burimet e financimit për vitet 2026, 2027, 2028 dhe përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028. Planifikimi i Burimeve të Financimit për Bashkinë Divjakë janë të detajuara sipas pasqyrës mëposhtë, gjithashtu në fund të projekt-vendimit është bashkëlidhur Raport PBA2 “Parashikimi i të Ardhurave”, ku zërat e financimit janë të detajuara sipas formatit të SMBV për PBA 2026-2028:

*në lekë*

<b>Burimet Buxhetore</b>	<b>Paras hikim 2026</b>	<b>Paras hikim 2027</b>	<b>Paras hikim 2028</b>
Trashëgimi nga Vitit i Kaluar	61,701,644	47,975,000	45,090,000
Të Ardhura nga Burimet e Veta	211,864,000	219,064,000	223,000,000
Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme	307,633,973	318,346,488	328,795,851
Niveli i rritjes se pagave T.P	41,043,007	41,043,007	41,043,007
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	167,078,102	167,078,102	167,078,102
<b>TOTALI (Grupi 00)</b>	<b>789,320,726</b>	<b>793,506,597</b>	<b>805,006,960</b>
Projekti Joinable, financimi i huaj me kapitulli 02	3,851,578	3,538,362	0
<b>TOTALI (Grupi 00) dhe Projektin Joinable (kapitull 02)</b>	<b>793,172,304</b>	<b>797,044,959</b>	<b>805,006,960</b>
Transferta e kushtëzuar	278,300,000	288,600,000	288,600,000
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE</b>	<b>1,071,472,304</b>	<b>1,085,644,959</b>	<b>1,093,606,960</b>

#### **TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME DHE SEKTORIALE**

Niveli i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2026-2028, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në qeverisjen vendore deri në vitin 2025. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës përkatëse të saj.

Shtojca1 “Parashikimi i transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për rritjen e pagave për bashkitë dhe qarqet për periudhën 2026-2028, Bashkëlidhur udhezimit nr.8



datë.28.02.2025 paraqet fondin e transfertës së përgjithsme të parashikuar për periudhën 2026-2028 dhe transfertën e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e pagave paraqitur si më poshtë:

Emertimi	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
Transferta e Pakushtëzuar	307,633,973	318,346,488	328,795,851
Transferta e pakushtëzuar sektoriale per rritjen e nivelit të pagave	41,043,007	41,043,007	41,043,007
<b>Transferta e Pakushtëzuar total</b>	<b>348,676,980</b>	<b>359,389,495</b>	<b>369,838,858</b>

\*Transferta për rritjen e pagave në vlerë 41,043,007 lekë përfaqson nivelin e rritjes së pagave në Shtator të vitit 2024(I pandryshuar deri më tani) dhe nuk është financim për rritjen e pagave në periudhat e ardhshme.

#### Transferta e pakushtëzuar sektoriale:

Niveli i transfertës së pakushtëzuar sektoriale, për funksionet e transferuara në nivel vendor në vitin 2016, për periudhën 2026-2028, bazohet në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal të miratuar (Shtojca nr.3).

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2026-2028, do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar me buxhetin e vitit 2025.

Vitet	njësia	plan 2026	plan 2027	plan 2028
<b>Transferta e pakushtëzuar sektoriale</b>	lekë	167,078,102	167,078,102	167,078,102

#### TË ARDHURAT VENDORE

Të ardhurat e veta përfshijnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore që realizon njësia e vetëqeverisjes vendore. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Divjakë Nr.7, datë 24.01.2025 "Për miratimin e raportit të vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave në Bashkinë Divjakë për vitet 2026-2028", parashikimi i të ardhurave vendore të Bashkisë Divjakë janë në nivelet si më poshtë:

Parashikim Viti 2026	Parashikim Viti 2027	Parashikim Viti 2028
<b>211,864,000</b>	<b>219,064,000</b>	<b>223,000,000 (në lekë)</b>

#### FINANCIM I HUAJ (02)

Bashkia Divjakë ka nënshkruar kontratën e partneritetit me Koordinatorin e Projektit Joinable, Bashkia Punat në Kroaci. Projekti ka qëllim zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për menaxhimin e mbetjeve plastike në rajonin ADRION duke nxitur zhvillimin e ekonomisë blu. Strategjia do të adresojë sfidat dhe mundësitë specifike brenda rajonit, duke synuar të reduktojë ndikimin mjedisor të mbetjeve plastike duke promovuar një rritje të qëndrueshme ekonomike përmes praktikave inovative të riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve. Sipas kontratës financimi i pritshëm nga Bashkimi Evropian nëpërmjet programit Interreg IPA ADRION është në vlerën

94,308 euro me shtrirje në vitet 2025, 2026, 2027 dhe financimi nga Bashkia Divjakë është në vlerën 16,643 euro për vitin 2025. Përfshirja e planit të financimit nga projekti Joinable në buxhetin e vitit 2025 është miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Divjakë nr.42 datë 25.07.2025, ndërsa plani (parashikimi) për vitet 2026 dhe 2027 është miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Divjakë nr.44 datë 25.07.2025. Programi buxhetor për këtë projekt është menduar 05100 "MENAXHIMI I MBETJEVE URBANE".

## TRANSFERTA E KUSHTËZUAR

**Transferta e kushtëzuar** parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2026-2028 për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara. Shuma e transfertave të kushtëzuara do të jetë rezultat i shpenzimeve sipas artikujve për çdo aktivitet që kryhet në zbatim të funksioneve të deleguara, ose të përbashkëta.

në lekë

Nr.	EMËRTIMI PROGRAMIT	Parashikim 2026	Parashikim 2027	Parashikim 2028
01170	GIJENDJA CIVILE	8,300,000	8,600,000	8,600,000
10430	PËRKUJDESJA SOCIALE, KUJDESI SOCIAL PËR PERSONA TË SËMURË DHE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	270,000,000	280,000,000	280,000,000
	<b>TRANSFERTA E KUSHTËZUAR</b>	<b>278,300,000</b>	<b>288,600,000</b>	<b>288,600,000</b>

## NDARJA E SHPENZIMEVE NË PROGRAME PËR TRE VITET E ARDHSHME

2-Shpenzimet e NJVQV-së sipas Njësive Shpenzuese (pa përfshirë parashikimin për Transfertat e Kushtëzuara).

në lekë

Njësia e Shpenzimit	Kodi i Njesisë së Shpenzimit	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028
Bashkia Divjakë	2147001	686,760,532.00	690,633,187.00	698,595,188.00
Agjencia e Shërbimeve Komunale	2147003	106,411,772.00	106,411,772.00	106,411,772.00
<b>TOTALI</b>		<b>793,172,304.00</b>	<b>797,044,959.00</b>	<b>805,006,960.00</b>

## Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Ekonomik (pa përfshirë parashikimin për Transfertat e Kushtëzuara).

Në pasqyrën e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik janë shpërndarë burimet buxhetore pa përfshirë parashikimin për transfertat e kushtëzuara, pasi i tillë është formati i SMBV.

Pasqyra e mëposhtme është për shpenzimet e Bashkisë Divjakë (në total) sipas klasifikimit ekonomik.

në 000/lekë



KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	PLA NI 202 6	PLA NI 202 7	PLA NI 202 8
	<b>Shpenzime Personeli (600-601)</b>	<b>451,140</b>	<b>451,140</b>	<b>449,509</b>
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	386,741	386,741	385,383
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	64,399	64,399	64,126
	<b>Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)</b>	<b>217,465</b>	<b>217,598</b>	<b>215,691</b>
602	Mallra dhe sherbime te tjera	196,763	196,896	194,989
603	Subvencionet	0	0	0
604	Transferime korrente te brendeshme	20,702	20,702	20,702
605	Transferimet korrente jashte	0	0	0
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0
651	Interesa per huamarrje te tjera te brendeshme	0	0	0
1661	Te dala, huamarrje te tjera afatgjate	0	0	0
	<b>Shpenzime Kapitale (230-232, 255)</b>	<b>124,567</b>	<b>128,307</b>	<b>139,807</b>
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	0	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	124,567	128,307	139,807
232	Shpenzime transferimet kapitale	0	0	0
255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>793,172</b>	<b>797,045</b>	<b>805,007</b>

Investimet dhe projektet e përfshira në Programin Buxhetor Afatmesëm janë pjesë kyçe e strategjisë së zhvillimit të bashkisë për vitet e ardhshme. Në kuadër të konsultimeve publike, këto projekte paraqiten për të marrë sugjerime dhe rekomandime nga qytetarët dhe grupet e interesit, duke siguruar përfshirjen e tyre në planifikim dhe vendimmarrje.

Karakteristikat kryesore të investimeve/projekteve në Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për konsultim publik:


1. Infrastrukturë publike: Investime në rrugë, ndriçim publik, kanalizime, përmirësimin e hapësirave publike dhe ndërtimin e objekteve të reja të rëndësisë komunitare (p.sh., shkolla, qendra shëndetësore).

2. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik: Projekte që nxisin zhvillimin ekonomik lokal, përfshirë investime në bujqësi, turizëm, dhe nisma për të mbështetur bizneset vendore. Këto përfshijnë edhe projekte që synojnë të rrisin potencialin turistik të zonës.

3. Mbrojtja e mjedisit: Projekte që fokusohen në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, si menaxhimi i mbetjeve.

Rëndësia e këtyre investimeve është që ato përfaqësojnë një angazhim afatgjatë për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet dhe për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm. Qytetarët kanë mundësinë të japin mendime për prioritetet dhe mënyrën e financimit të këtyre projekteve gjatë konsultimeve publike.

Nr.	PROGRAMI	Emërtimi i investimit/projektit	Plan 2026	Plan 2027	Plan 2028	Shënime
1	<p><b>Programi 01110 (PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM). Në numrin rendor 8 dhe 9 pjesëmarrësit mund të japin sugjerime për planifikimin e investimeve për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe funksionimin e aparatit të Bashkisë për vitin 2027 dhe 2028.</b></p>	Ndricim ne rruget e territorit te Bashkise Divjake (Kodi 1470173)	5,000,000			Investim per vitin 2025, me planifikim likujdimi ne vitet 2025 dhe 2026.
2		Blerje materiale per zyrat e Bashkise Divjake (Kodi 1470175)	1,967,000	2,990,000		Investim per vitin 2025, me planifikim likujdimi ne vitet 2025, 2026 dhe 2027.
3		Blerje trailer per transport mbetjesh urbane (Kodi 1470185)	3,763,000	1,737,000		Investim per vitin 2025, me planifikim likujdimi ne vitet 2025, 2026 dhe 2027.
4		Ndricim ne rruget e territorit te Bashkise Divjake per vitin 2026.	5,000,000	5,000,000		Investim per vitin 2026, me planifikim likujdimi ne vitet 2026 dhe 2027.
5		Blerje kosha metalik Xingato viti 2026	5,000,000			Investim per vitin 2026.
6		Blerje kosha metalik Xingato viti 2027		5,000,000		Investim per vitin 2027.
7		Blerje kosha metalik Xingato viti 2028			5,000,000	Investim per vitin 2028.
8		Investim per tu planifikuar viti 2027 (Te diskutohet)		9,188,515		Pjesëmarrësit në konsultimin publik mund të japin mendime dhe sugjerime.
9		Investim per tu planifikuar viti 2028 (Te diskutohet)			25,730,000	
10		<p><b>Programi 06260 (SHËRBIME PUBLIKE VENDORE). Në numrin rendor 10, 11 dhe 12 pjesëmarrësit mund të japin sugjerime për planifikimin e investimeve për sipërfaqe të gjelbër të mirëmbajtur dhe</b></p>	Investim per tu planifikuar viti 2026 (Te diskutohet)	1,620,000		
11	Investim per tu planifikuar viti 2027 (Te diskutohet)			1,620,000		



12	rehabilituar, etj. për vitin 2027 dhe 2028.	Investim per tu planifikuar viti 2028 (Te diskutohet)			1,620,000	
13	Programi 04520 (RRJETI RRUGOR RURAL). Në numrin rendor 20 dhe 21 pjesëmarrësit mund të japin sugjerime për planifikimin e investimeve për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrjetin rrugor rural, etj. për vitin 2027 dhe 2028.	Blerje binderi per shtrimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjake. (Kodi i Projektit-1470121)	24,000,000			Investim i trashëguar ne vitin 2025, me planifikim likujdimi ne vitet 2025 dhe 2026.
14		Blerje çakell makinerie (1-100mm) per rruget urbane te Bashkise Divjake. (Kodi i Projektit-1470122)	3,501,760			Investim i trashëguar ne vitin 2025, me planifikim likujdimi ne vitet 2025 dhe 2026.
15		Blerje binderi per shtrimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjake. (1470177)	30,000,000	34,257,000		Investim per vitin 2025, me planifikim likujdimi ne vitet 2025, 2026 dhe 2027.
16		Blerje cakell makinerie (sp1-100 mm) per rruge urbane dhe rurale ne Bashkine Divjake (1470178)	11,942,240	14,263,760		Investim per vitin 2025, me planifikim likujdimi ne vitet 2025, 2026 dhe 2027.
17		Blerje binderi per shtrimin e rrugeve urbane, Bashkia Divjake. Viti 2026	19,847,692	15,152,308	15,000,000	Investim per vitin 2026, me planifikim likujdimi ne vitet 2026, 2027 dhe 2028.
18		Blerje tuba te brinjezuar, KUB dhe KUZ, Bashkia Divjake. Viti 2026	3,000,000			Investim per vitin 2026.
19		Blerje cakell makinerie (sp1-100 mm) per rruge urbane dhe rurale ne Bashkine Divjake. Viti 2026	7,000,000	5,000,000	6,000,000	Investim per vitin 2026, me planifikim likujdimi ne vitet 2026, 2027 dhe 2028.

20		Investim per tu planifikuar viti 2027 (Te diskutohet)		31,618,980		Pjesëmarrësit në konsultimin publik mund të japin mendime dhe sugjerime.
21		Investim per tu planifikuar viti 2028 (Te diskutohet)			83,977,926	
22	<b>Programi 09120 (ARSIMI BAZË PËRFSHIRË PARASHKOLLORIN).</b> <b>Në numrin rendor 23, 24 dhe 25 pjesëmarrësit mund të japin sugjerime për planifikimin e rikonstruksioneve të objekteve të arsimit bazë dhe parashkollor, etj, për vitin 2027 dhe 2028.</b>	Blerje kamera sigurie per Kopshtin me dreke, Cerme Sektor.	1,000,000			Investim per vitin 2026.
23		Investim per tu planifikuar viti 2026 (Te diskutohet)	1,478,981			Pjesëmarrësit në konsultimin publik mund të japin mendime dhe sugjerime.
24		Investim per tu planifikuar viti 2027 (Te diskutohet)		2,478,981		
25		Investim per tu planifikuar viti 2028 (Te diskutohet)			2,478,981	
26	<b>Programi 09230 (ARSIMI IMESËM I PËRGJITHSHËM).</b>	Mbikeqyrje punimesh: ndertim palestere te mbuluar dhe rikonstruksion i shkolles se mesme te bashkuar Cerme Sektor. (Kodi i Projektit-1470102)/08140	446,644			Investim i trashëguar ne vitin 2025 dhe me likujdim dhe në vitet 2025 dhe 2026
<b>TOTALI</b>			<b>124,567,317</b>	<b>128,306,544</b>	<b>139,806,907</b>	

Pjesëmarrësit në konsultimin publik mund të japin mendime dhe sugjerime për mënyrën se si bashkia mund të administrojë më mirë fondet dhe të rrisë transparencën. Pas përfundimit të procesit të konsultimit, Bashkia Divjakë përgatit një dokument përmbledhës të propozimeve të marra dhe ndryshimet e bëra në buxhet në bazë të tyre. Kjo ndihmon në përmirësimin e përvojës së qytetarëve dhe në adresimin e nevojave më të ngutshme të komunitetit.

**Përgjegjës i Sektorit Juridik, Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit të Aseteve**  
**Andi BULLARI**

**Drejtor i Taksave dhe të Ardhurave Vendore**  
**Alketa HILA**

**Përgjegjëse e Buxhetit dhe MFK**  
**Irena GJONI**

**Drejtor i Financës dhe Buxhetit**  
**Xheladin BRAHKOLA**

**KRYETARI**

**JOSIE GORREA**

Adresa: Pranë Sheshit "Santa Barbara", Divjakë

e-mail: info@bashkiadivjake.gov.al



## Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave

NJVQV: 147 - Bashkia Divjakë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
<b>1</b>	<b>TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA</b>	126,119	138,101	188,690	188,690	180,664	186,864	189,800
<b>1.1</b>	<b>TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME</b>	45,060	49,638	75,698	75,698	57,598	61,598	65,498
1.1.1	Taksa mbi Ndërtesën	12,983	12,450	23,000	23,000	17,000	19,000	21,000
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	31,546	36,535	51,918	51,918	39,818	41,818	43,718
1.1.3	Taksa mbi truallin	531	347	340	340	340	340	340
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	0	306	440	440	440	440	440
<b>1.2</b>	<b>TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA</b>	11,007	4,961	9,000	9,000	13,500	14,000	14,500
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	11,007	4,961	9,000	9,000	13,500	14,000	14,500
<b>1.3</b>	<b>TAKSA TË TJERA VENDORE</b>	521	578	609	609	2,880	2,980	2,580
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	15	0	0	0	2,100	2,200	1,800
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	294	372	397	397	390	390	390
1.3.3	Taksa e tabelës	212	207	212	212	390	390	390
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
<b>1.4</b>	<b>TARIFA VENDORE</b>	65,581	78,259	97,331	97,331	91,186	92,286	92,722
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	22,392	23,406	30,100	30,100	32,621	32,821	33,100
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	5,826	7,405	7,100	7,100	5,000	5,000	5,000
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	6,077	6,511	8,062	8,062	8,165	8,350	8,550
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	2,300	3,432	3,273	3,273	2,300	2,300	2,100
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	294	330	400	400	2,000	2,000	1,500

## Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave

NJVQV: 147 - Bashkia Divjakë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	<b>Burimet Buxhetore</b>	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	643	1,964	2,300	2,300	2,500	2,500	2,300
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	0	75	135	135	100	100	135
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	7,553	7,840	12,000	12,000	11,900	12,000	12,000
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	4,201	3,120	2,300	2,300	1,500	1,000	1,000
1.4.11	Tarifa e parkimit	47	199	200	200	0	0	0
1.4.12	Tarifa të tjera	16,248	23,977	31,461	31,461	25,100	26,215	27,037
<b>1.5</b>	<b>TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK</b>	<b>3,950</b>	<b>4,665</b>	<b>6,052</b>	<b>6,052</b>	<b>15,500</b>	<b>16,000</b>	<b>14,500</b>
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të bashkisë	3,950	4,665	6,052	6,052	7,000	7,000	7,000
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0
1.5.5	Shitja e asetëve financiare	0	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e asetëve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	8,500	9,000	7,500
1.5.7	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
<b>1.6</b>	<b>TË TJERA ADMINISTRATIVE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
1.6.1	Kamatëvonesat	0	0	0	0	0	0	0
1.6.2	Gjoha, sekuestime dhe zhvendime	0	0	0	0	0	0	0
1.6.3	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0
<b>2</b>	<b>TRANSFERTA NGA BUXHETI QËNDROR</b>	<b>710,202</b>	<b>1,320,064</b>	<b>899,296</b>	<b>1,012,721</b>	<b>794,055</b>	<b>815,068</b>	<b>825,517</b>

## Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave

NJVQV 147 - Bashkia Divjakë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
<b>2.1</b>	<b>TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME</b>	305,303	331,939	338,137	338,137	348,677	359,389	369,839
2.1.1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	305,303	282,939	297,094	297,094	307,634	318,346	328,796
2.1.2	Rritja e nivelit të pagave	0	27,213	41,043	41,043	41,043	41,043	41,043
2.1.3	Fond shtesë nga Kuvendi	0	21,786	0	0	0	0	0
<b>2.2</b>	<b>TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE</b>	121,168	307,324	167,078	167,078	167,078	167,078	167,078
2.2.1	Konviktet e arsimit parauniversitar	0	0	0	0	0	0	0
2.2.2	Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	61,944	69,781	82,527	82,527	82,527	82,527	82,527
2.2.3	Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	0	1,838	1,912	1,912	1,912	1,912	1,912
2.2.4	Arsimi parauniversitar	1,506	1,582	1,645	1,645	1,645	1,645	1,645
2.2.5	Mbrojtja nga zjarri	14,492	16,447	19,011	19,011	19,011	19,011	19,011
2.2.6	Mbrojtja sociale	0	0	0	0	0	0	0
2.2.7	Administrimi i pyjeve	1,014	1,057	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100
2.2.8	Rrugët	9,181	9,624	9,926	9,926	9,926	9,926	9,926
2.2.9	Ujitja dhe Kullimi	33,031	34,001	35,359	35,359	35,359	35,359	35,359
2.2.10	Klubet shumësportëshe "Partizani" dhe "Studenti"	0	0	0	0	0	0	0
2.2.11	Menaxhimi i mbetjeve urbane	0	15,000	15,599	15,599	15,599	15,599	15,599
2.2.12	Të tjera	0	157,993	0	0	0	0	0
<b>2.3</b>	<b>TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA</b>	283,731	680,802	394,081	507,506	278,300	288,600	288,600
2.3.1	Për funksione të deleguara	247,784	238,951	267,900	270,424	278,300	288,600	288,600
2.3.2	Për projekte të veçanta	35,947	441,851	126,181	237,082	0	0	0

**Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave**

NJVQV: 147 - Bashkia Divjakë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	Burimet Buxhetore	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
<b>2.4</b>	<b>TRANSFERTË SPECIFIKE</b>	0	0	0	0	0	0	0
2.4.1	Transfertë specifike	0	0	0	0	0	0	0
<b>3</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>	30,885	34,084	29,930	29,930	31,200	32,200	33,200
3.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	16,671	18,315	18,000	18,000	19,200	19,200	19,200
3.2	Renta minerare	0	0	0	0	0	0	0
3.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	14,108	15,769	11,930	11,930	12,000	13,000	14,000
3.4	Të tjera	106	0	0	0	0	0	0
<b>4</b>	<b>GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA</b>	0	0	0	1,841	3,852	3,538	0
<b>4.1</b>	<b>TRANSFERTA NGA I NJËJTI NIVEL QEVERISJE</b>	0	0	0	0	0	0	0
4.1.1	Transferta nga i njëjti nivel qeverisje	0	0	0	0	0	0	0
<b>4.2</b>	<b>GRANTE TË TJERA TË BRENDSHME</b>	0	0	0	0	0	0	0
4.2.1	Grante të Tjera të Brendshme	0	0	0	0	0	0	0
<b>4.3</b>	<b>GRANTE TË HUAJA</b>	0	0	0	1,841	3,852	3,538	0
4.3.1	Grante të huaja	0	0	0	1,841	3,852	3,538	0
<b>5</b>	<b>HUAMARRJA</b>	0	0	0	0	0	0	0
5.1	Huamarrja afatshkurtër	0	0	0	0	0	0	0
5.2	Huamarrja afatgjatë	0	0	0	0	0	0	0
<b>6</b>	<b>TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR</b>	59,925	102,451	269,051	394,580	61,702	47,975	45,090
6.1	Trashëgimi pa destinacion	33,645	35,169	269,051	269,051	61,702	47,975	45,090
6.2	Trashëgimi me destinacion	26,280	67,281	0	125,530	0	0	0

**Raporti: PBA2 - Parashikimi i të Ardhurave**

NJVQV: 147 - Bashkia Divjakë

PBA: 2026 - 2028

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	<b>Burimet Buxhetore</b>	2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillestar	2025 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE TË NJVQV</b>		927,131	1,594,700	1,386,967	1,627,762	1,071,472	1,085,645	1,093,607

